



Datë: 29.05.2025

Numër Protokolli: 3688/2025

A.nr.461/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.461/2025, të datës 13.02.2025, të parashtruar nga ankuesja G.B., kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilani, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim më datë 29.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.461/2025, e datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesja G.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 02-016-19974 i datës 12.03.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil G.B. (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesja*), më datë 13.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: *Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) e administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1641/2025 të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar

për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Emailin e datës 12.03.2025 dhe 13.03.2025 nga ankuesja për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Njoftimin e datës 24.02.2025 për verifikimin paraprak; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin me numër protokolli 02-016-19974 i datës 12.03.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.04.2025; Aplikacionin e ankueses të datës 13.01.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-16; Aplikacionin e kandidatit F.J të datës 20.01.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-21; Vendimin e datës 03.03.2025 për formimin e komisionit të pranit dhe akt emërimit e anëtareve të komisionit; Listën e aplikantëve; Njoftimin për testin me shkrim për ankuesen i datës 28.02.2025; Rezultatin e testit me shkrim; Njoftimin për intervistë me gojë i datës 10.03.2025; Formularët e vlerësimit të intervistë me gojë për kandidatin fitues; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Vendimin me numër protokolli 2845/2025 të datës 29.04.2025 për shtytjen e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Gjilanit, më datë 10.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me klasë të pozitës Profesional 2, i hapur për aplikim nga data 11.01.2025 deri më datën 09.02.2025.

Rrjedhimisht, në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar 64 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar testit me shkrim mirëpo nuk e ka kaluar të njëjtin.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, më datë 12.03.2025 ka publikuar Njoftimin për listën përfundimtare të kandidatëve fitues, nga rezulton se si kandidatë fitues për procedurën përkatëse janë shpallur: F.J. me 80.6 pikë dhe F.B. me 72.8 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në këtë konkurs ka pasur shkelje procedurale, në veçanti, komisioni i pranimit ka qenë në kundërshtim me legjislacionin sepse edhe ushtruesi i detares nuk mund të jetë anëtar i komisioni. Kriteret e konkursit kanë qenë në kundërshtim sepse për këtë pozitë duhet me qenë si hap i parë Juristi e jo çdo profesion mund të ushtroj këtë pozitë. Rezultati i testit është vonuar 4 ditë. Kërkon të anulohet konkursi.

Kolegji i Këshilli, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00016336, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me klasë të pozitës Profesional 2, i hapur për aplikim nga data 11.01.2025 deri më datën 09.02.2025, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Arsim i lartë i paspecifikuar; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.* dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kane qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar*

publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisnin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Tutje, Kolegji i Këshillit i`u referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës” dhe nenit 42 paragrafi 2, ku përcaktohet: 2. Komisioni i pranimi për kategorinë e specialistes/it ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse për pozitën apo grupin e pozitave për të cilat zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/es nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) profesore/r i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen administrative në procedurë ankimore, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- **Nenin 7:** Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

-**Nenin 8:** Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimi me mbështetjen e NjMBNj.

Neni 9 Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni behët publike nga NjMBNj në SIMBNJ, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Neni 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

-Nenin 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNJ, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

- Nenin 20 paragrafi 2, ku përcaktohet: 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNJ; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vendimin me numër protokolli 02 Nr. 297 të datës 03.03.2025 për formimin e Komisionit të Pranimit, dhe në bazë të vendimit të cekur më lartë përveç anëtarëve permanent kanë pasur edhe anëtar zëvendësues, dhe në bazë të shqyrtimit të akteve të emërimit të anëtarëve që kanë marr pjesë në vlerësim e kandidatëve rezulton se B.K., si kryesues, mban pozitën Menaxher i Burimeve Njerëzore, anëtarët M.Z. sipas akt emërimit mban pozitën Drejtor i QPS-së, S.A. sipas akt emërimit mban pozitën Shef i Shërbimit të Kuvendit, F.A. sipas akt emërimit mban pozitën Zyrtar Ligjor, mirëpo sipas Vendimit 02 Nr.4011 të datës 10.09.2024 është caktuar ushtrues detyre në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile dhe Vendimit 02 Nr.320 të datës 07.03.2025 përmes se cilit është caktuar edhe për 6 muaj tjerë Ushtrues detyre në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile, si dhe dhe Lindita Salihu sipas Akt Emërimit mban pozitën Zyrtare për Barazi Gjinore. Rrjedhimisht mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se komisioni i pranimit ka qenë i formuar në pajtim me dispozitat përkatëse në fuqi, ndërsa lidhur me pretendimin se ushtruesi i detyrës nuk mund të jetë anëtar i komisionit, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ushtruesi i detyrës së një pozite përkatëse i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet sikurse të ishte në pozitë të përhershme ngase i njëjti ushtron pozitën përkatëse sipas vendimit, dhe mbi këtë bazë nuk ka asnjë pengesë ligjore për pjesëmarrje në komision të pranimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se për këtë pozitë duhet me qenë si hap i parë Juristi e jo çdo profesion mund të ushtroj këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kriteret në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë të përcaktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi gjegjësisht në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pasi që pozita e shpallur Zyrtar për Mbrojtje nga Diskriminim, hynë në kuadër të Klasës Profesional 2 në Grupin e Administrimit të Përgjithshëm e që kërkohet që kandidatet të kenë arsimim të lartë të paspecifikuar, andaj në kuadër të kësaj pretendimi i ankueses është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se rezultati i testit është vonuar 4 ditë, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se sipas njoftimit të datës 24.02.2025 është përfunduar faza e verifikimit paraprak dhe kandidatët që kanë kaluar këtë fazë përmes emailit të datës 28.02.2025 janë ftuar për testin me shkrim më datë 04.03.2025, ndërsa më datë 07.03.2025 është publikuar njoftimi për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas përcaktimeve ligjore të cekura më lartë, përcaktohet se pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit, në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ, si rezultat i kësaj, duke marr parasysh faktin se testi me shkrim është mbajtur më datë 12.03.2025 ndërsa rezultatet janë publikuar më datë 14.03.2025, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë aspekt nuk ka asnjë shkelje procedurale apo materiale, sepse nuk është përcaktim ligjor që rezultati i testit me shkrim të publikohet ditën kur mbahet testin me shkrim, dhe e rëndësishme është po ashtu edhe ligjore që intervista me gojë të mbahet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve të testit me shkrim e një gjë e

tillë është bërë ngase sipas njoftimit të datës 10.03.2025, kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim janë njoftuar se intervista me gojë do të mbahet më datë 12.03.2025, në rrethanat e rastit konkret pretendimi i ankueses se rezultatet e testit me shkrim janë vonuar për katër ditë nga dita e mbajtjes së testit me shkrim, është i pabazuar.

Duke marr parasysh që procedura e pranimit ka përfunduar me kandidatë fitues, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dosjen e kandidatëve fitues për procedurën e pranimit me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga dhe ka gjetur se:

-Kandidati F.J., posedon Diplomën Nr.55/2015 të datës 04.09.2015 të lëshuar nga Kolegji Gjilani me të cilën dëshmohet se më datës 09.07.2015 ka përfunduar studimet themelore në programin Menaxhmet duke marr titullin Bachelor i Arteve në Menaxhment. Ndërsa përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit i njëjti posedon Vërtetimin me numër protokolli 3626.43-09 të datës 28.05.2023 të lëshuar nga Kolegji për Biznes dhe Teknologji UBT, me të cilën dëshmohet se ka qenë i angazhuar në pozitën Financa dhe Kontabilitet prej datës 05.01.2022 deri më datë 01.11.2023 të cilën e ka mbështetur edhe me dëshmi nga pagesa e kursimeve pensionale.

Kështu që referuar konstatimeve si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë procedurë të pranimit nuk është ecidentuar ndonjë shkelje procedurale apo materiale dhe po ashtu nuk është konstatuar ndonjë cenim i të drejtave të ankueses në raport me procedurën, dhe për rrjedhojë, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës konkursin me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është zhvilluar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 4, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që Njoftimi me numër protokolli 02-016-19974 i datës 12.03.2025 i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016197, për Grupin e administrimit të përgjithshëm, respektivisht për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.461/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, G.B.;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*